




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.11.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.10.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 882, të datës 30.09.2020, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 46, paragrafi 46.2, të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë Nr. 03/L-048, (Gazeta Zyrtare 27/2008), nenin 27, shkronja (ç, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 25, paragrafi 4, nenin 27, paragrafi 2, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M


Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit 2020

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në Komunën e Fushë-Kosovës për periudhën janar-qershor të vitit të 2020, në shumë të përgjithshme prej 4,403,041.39€.
2. Buxheti i shpenzuar sipas programeve është si vijon:
 - 2.1 Në administratën komunale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,682,048.39€;
 - 2.2 Në arsim, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 1,959,891.93€;
 - 2.3 Në shëndetësi dhe Qendrën për Punë Sociale, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 746,180.27€;
 - 2.4 Në Zyrën e Komuniteteve, buxheti i shpenzuar është në shumë prej 14,920.80€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës


Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 05.11.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.10.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 951, të datës 21.10.2020, paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 9, nenin 12, nenin 20, të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr. 06/L-005, (Gazeta Zyrtare, e datës 26 janar 2018), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 32, paragrafi 1, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës cakton normat tatimore për vitin 2021, për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë së pronës publike, si vijon:

- Për njësité bujqësore të parcelave----- (0.15%)
- Për njësité bujqësore të objekteve----- (0.15%)
- Për njësité pyjore të parcelave----- (0.15%)
- Për njësité rezidenciale të parcelave----- (0.15%)
- Për njësité rezidenciale të objekteve----- (0.15%)
- Për njësité komerciale të parcelave----- (0.15%)
- Për njësité komerciale të objekteve----- (0.22%)
- Për njësité industriale të parcelave----- (0.15%)
- Për njësité industriale të objekteve----- (0.15%)

Neni 2

Zbatimi

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtorati për Zhvillim Ekonomik - Sektori për Tatim në Pronë.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së ZHE dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 06.11.2020

Për: Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, Ministrin z. Blerim Kuqi
Sekretaren Permanent të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit z. Fatos Qerimi
Korporatën Energjetike të Kosovës. Sh.A. Kryeshefin Ekzekutiv z. Luigj Imeri

Prej: Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, Vjollca Konjusha



Lënda: Kërkesë për prioritet në punësimin e banorëve të Komunës së Fushë-Kosovës

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datën 30.10.2020, pas shqyrtimit të kërkesës-peticionit të banorëve të fshatit Bardh i Madh me Nr. 02-070/05-0029110/20, të datës 27.10.2020 dhe kërkesës së banorëve të fshatit Graboc i Poshtëm me Nr. 02-070/05-0029558/20, të datës 30.10.2020, ka vendosur që t'i drejtohet me një kërkesë zyrtare Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit që në aspektin formal si institucion shtetërorë, merret me menaxhimin e kompanive publike të vendit tonë, të kërkon nga Korporata Energjetike e Kosovës, që t'i jap prioritet në punësim banorëve të këtyre dy fshatrave të cekura më lartë dhe qytetarëve tjerë të Fushë-Kosovës në Korporatën Energjetike të Kosovës, sepse të gjithë e kemi të njohur faktin, se banorët e këtyre dy fshatrave janë të dëmtuar shumë nga veprimtaria prodhuese dhe ekonomike e korporatës, duke krijuar probleme të njohura gjatë viteve si: marrja e tokës së punës, mungesa e ujit, ndotja e ajrit, dëmtimi i ambientit dhe rrugëve, andaj ne kërkojmë që kjo korporatë të ketë parasysh gjendjen reale, pa punësinë e të rinjëve të zonës në fjalë dhe të ndërmerrë masa adekuate për caktimin e prioritetit për punësimin e të rinjëve, sidomos nga këto dy fshatra. Kërkesa e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës e miratuar me unanimitet të votave, i kërkon Korporatës Energjetike të Kosovës, që në konkurset e hapura për punësime, të merr parasysh këto fakte dhe të punëson një numër të caktuar të qytetarëve të Komunës së Fushë-Kosovës, si dhe në kushte të barabarta t'i jepin prioritet në të gjitha pozitat dhe profilet: ekonomistë, juristë, teknik të makinerisë, elektrikistë, axhustator dhe vende të tjera të punës sipas nevojave të korporatës energjetike.


Sqarim: Kërkesës i bashkëngjeshim materialit përcjellës!

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.11.2020

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.10.2020, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 579 të datës 20.07.2020, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 18, paragrafi 3, nenin 45, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për Shëndetësi Nr. 04/L-125, (Gazeta Zyrtare 13/2013), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, miraton këtë:

Ndryshim-plotësim të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 140, të datës 29.09.2017

Neni 1

Për ndryshim-plotësimin e nenit 3, të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 140, të datës 29.09.2017 lidhur me emërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare Nr. 5 në rrugën ‘28 Nëntori’ në Fushë-Kosovë dhe vendosjen e saj në organogramin e institucioneve të kujdesit parësorë shëndetësorë.

Neni 2

2. Me këtë ndryshim plotësim të cekur në paragrafin një struktura organizative e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë me njësitë e saj përbërëse është si vijon:
 - 2.1 Ambulanta e Mjekësisë Familjare - Fushë-Kosovë;
 - 2.2 Ambulanta e Mjekësisë Familjare - Kuzmin;
 - 2.3 Qendra e Mjekësisë Familjare Nr. 1 - Bardh i Madh;
 - 2.3.1 Ambulanta e Mjekësisë Familjare - Graboc i Poshtëm;
 - 2.3.2 Ambulanta e Mjekësisë Familjare - Bardh i Vogël;
 - 2.4 Qendra e Mjekësisë Familjare Nr. 2 - Sllatinë e Madhe;
 - 2.4.1 Ambulanta e Mjekësisë Familjare - Henc;
 - 2.5 Qendra e Mjekësisë Familjare Nr. 3 - Miradi e Poshtme;
 - 2.5.1 Ambulanta e Mjekësisë Familjare - Vragoli;
 - 2.6 Qendra e Mjekësisë Familjare Nr. 4 - Miradi e Epërme dhe
 - 2.7 Qendra e Mjekësisë Familjare Nr. 5 - Fushë-Kosova.

Neni 3

Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij ndryshim - plotësimi të nenit 3, të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 140, të datës 29.09.2017, lidhur me emërtimin dhe organogramin e institucioneve shëndetësore në Komunën e Fushë-Kosovës është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

Neni 4

Ky ndryshim-plotësim i statutit hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe është pjesë e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Komunën e Fushë-Kosovës Nr. 140, të datës 29.09.2017.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

